



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi \_ dhe neni 23 të Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë „, numër 12 / 2019 ) neni 40 dhe 41 të Rregullores për punë të Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit, duke vepruar sipas raportit për denoncim të korrupsionit nga parashtruesit ..... dhe ....., Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 42-të e mbajtur me datë 11 dhjetorë të vitit 2020 miratoi në vijim

### Vendim

Denoncimi me nr. 12-4914/1 i datës 21.10.2019 , është parashtruar nga ..... dhe ....., si përfaqësues të aksionerëve të dëmtuar të SHA ,,.....,, Radovish, **REFUZOHET**.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit nuk ka elemente që me kompetencat e saj të veprojnë në lëndën me numër 12 - 4914 të vitit 2019 e formuar në bazë të kërkesës me nr. 12-4914/1 të datës 21.10.2019.

Lënda me numër 12-4914/1 nga viti 2019 të mbyllët dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dërgohet Vendimi i KSHPK-së, me sqarim.

Vendimi i Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit, me sqarim të depersonalizuar të publikohet në ëeb faqen e Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit me afat prej 5 (pesë) ditësh nga sjellja e vendimit.

### Sqarim

Lënda me numër 12-4914 nga viti 2019 e formuar në bazë të denoncimit 12-4914/1 të datës 21.10.2019, e parashtruar para Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) , nga parashtruesi ..... dhe ..... si përfaqësues të aksionerëve të dëmtuar të SHA,,.....,, Radovish.

Denoncimi i parashtruar pretendon akuza për paknaqësi/ankesë në lidhje me lëndën OK.nr.54/09 e cila është udhëhequr në gjykatën Themelore Shkupi 2 në procesin gjyqësor të filluar në vitin 2009 kundër personit ..... dhe personave tjerë për shkak të krimit të kryer në SHA,,.....,, Radovish dhe kërkohet prej KSHPK-së që të vërtetojë përse është prolonguar sjellja e aktvednimit nga ana e gjykatës kompetente.

Gjatë shqyrtimit të rastit të denoncua, Komisioni shtetëror i merë parasysh pretendimet e denoncuesit dhe konstaton si në vijim:

Në denoncimin e parashtruar theksohet se procedurat e dëshmisë për lëndën ishin plotësisht të kryera dhe është pritur vetëm të sillet aktvendimi, por e njëjta vazhdimisht është prolonguar dhe nukë është dituar arsyeja e prolongimit. Parashtruesit e denoncimit janë të interesuar që të involvohen si palë të dëmtuara duke qenë si puntorë të mëparshëm të Shoqatës aksionare të lartëpërmendur, dhe informojnë se objektet e kompanisë së lartëpërmendur akoma punojnë , shfrytëzohen dhe keqpërdoren na personi i përmendur më lartë dhe djali i tij, në dëmë të të punësuarve si aksioner si dhe shtetit.

Në lidhje me rastin e lëndës ka Aktgjykim pre 65 faqeve, e sjellur nga gjykata Themelore Shkupi 1, e datës 28.01.2016, me numër II KOK. nr. .... /..... nga data 10.09.2009 për vepër të kryer penale keqkërdorim i pozitës zyrtare, autorizim për larje parashë dhe benificione tjera kundër personave ..... , ..... , të dy nga Radovishi si persona përgjegjës të kompanisë SHA ”.....” Radovish dhe personi ..... gjykatës në gjykatën themelore .....

Me sjelljen e aktgjykimit personat e akuzuar shpallen fajtorë, përshtakë të shfrytëzimit të pozitës së tyre dhe autorizimit të personave përgjegjës dhe shoqërues të SHA. Dhe të ndihmuar nga gjykatësi i akuzuar i cili ka sjellë vendim me qëllim që në mënyrë të padrejtë ta përvetësojnë të gjithë pronën e Kompaninsë së lartëpërmendur, në dëmë të aksionerëve tjerë – Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidorë i RMVsë, si posedues i 3.150 i aksioneve prioritare dhe aksioner të tjerë – persona fizikë të dëmtuar posedues të 755 aksioneve të thjeshta, mes të cilave edhe aksionet e dy personave që parashtruan denoncimin. Personat e akuzuar ishin gjykuar me kusht me burg (nga një vitë dhe tre vjetë për gjyqtarin ) dhe ishin të detyruar që në mënyrë solidare ta kompenzojnë shumën e personave të dëmtuar- Fondit Pensional Invalidor të RMVsë dhe personave fizikë në afat prej tre muajve pas hyrjes në fuqi të aktvendimit, nëse nuk realizohet ky detyrim të kryhet dënimi i përcaktuar me burg . Gjithashtu Gjykata nga personat e akuzuar, ..... dhe ..... , ka konfiskuar pronën hotel ..... në Radovish, si pron e putndëshmë e cila ka funksionuar si kazino.

Në bazë të gjithë asaj që është përmendur me lartë, KSHPK përcakton se nuk janë konfirmuar pretendimet e parashtruara në lëndë në raport me atë që nuk është sjellur aktgjykim, kurse në rastin konkret është vepruar nga organi kompetent – Gjykata themelore Shkupi 1, e cila me datë 28.01.2016 ka sjellur aktgjykim me të cilin personat e akuzuar ishin të shpallur si fajtorë dhe të njëjtit ishin të detyruar ti kompenzojnë aksionerët e dëmtuar, në mesin e të cilëve ishin edhe parashtruesit e denoncimit, a në të njëjtën kohë nga a Gjykatës ishte e konfiskuar prona/hotel nga personat e akuzuar si pronë e cila ishte marur me verpimtari të kazinove. Në bazë të të dhënave të cilat e vërtetojnë gjendjen faktike , KSHPK vleronë se nuk ka elemente për tui qasur kësaj lëndë me kompetencat e saja, parashtrimi i denoncimit refuzohet, kurse lëndë duhet të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke iu referuar asaj që është përmendur më lartë, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit vendose në bazë të dispozitave të këtij vendimi.

**E vesndosur me datën 11 dhjetorë të vitit 2020 me nr. 12 - 4914 / 2**

E dërguar deri tek: Arkiva  
Me përfundim të KSHPK,  
Punoi; J.C këshilltarë  
Miratoi : G.T.antar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËROР PËR  
PARANDALIM TË KORRUPSIONIT  
Kyetar: Biljana Ivanovska

